

Karta Evropiane e Sporteve e Rishikuar



Marrëveshja e Pjesshme e Zgjeruar për Sportin,
Këshilli i Evropës

Enlarged Partial Agreement on Sport



Accord partiel élargi sur le sport

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Karta Evropiane e Sporteve e Rishikuar

Rekomandimi CM/Rec(2021)5
miratuar nga Komiteti i Ministrave
më 13 tetor 2021 në mbledhjen e 1414-të
të Zëvendësministrave

Mendimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “© Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose të një pjese të tij duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimit, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë dokument duhet t’i drejtohen Marrëveshjes së Pjesëshme të Zgjeruar për Sportin, (EPAS) të Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës, F-67075 Strasbourg Cedex, E-mail: sport.epas@coe.int

Kopertina dhe faqesja: Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve dhe Botimeve (DPDP), Këshilli i Evropës

Ky botim nuk është redaktuar nga Njësia Editoriale e Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve dhe Botimeve për të korrigjuar gabimet tipografike dhe gramatikore.

© Këshilli i Evropës,
qershor 2022
Shtypur nga Këshilli i Evropës

Përmbajtja

REKOMANDIMI CM/REC(2021)5	
MBI KARTËN EVROPIANE TË PORTEVE TË RISHIKUAR	5
A. DISPOZITA HYRËSE	11
Neni 1 – Qëllimi i Kartës	11
Neni 2 – Përkufizimi i "sportit" dhe fusha e zbatimit të Kartës	12
B. PALËT E INTERESIT	14
Neni 3 – Autoritetet publike	14
Neni 4 – Lëvizja sportive	14
Neni 5 – Sektorët e korporatave dhe profesionalë	15
C. SPORTI I BAZUAR NË VLERA	17
Neni 6 – Të drejtat e njeriut	17
Neni 7 – Edukimi i vlerave përmes etikës sportive	18
Neni 8 – Integriteti	19
Neni 9 – Qëndrueshmëria	20
D. SPORTI PËR TË GJITHË	22
Neni 10 – E drejta për sport	22
Neni 11 – Ndërtimi i themeleve për praktikimin e sportit	23
Neni 12 – Zhvillimi i pjesëmarrjes	24
Neni 13 – Përmirësimi i performancës	24
Neni 14 – Mbështetja e sportit të nivelit të lartë dhe atij profesional	25

E. MJETET	27
Neni 15 – Objektet dhe aktivitetet	27
Neni 16 – Burimet njerëzore	27
Neni 17 – Informacion dhe hulumtim	28
Neni 18 – Financa	29
Neni 19 – Bashkëpunimi i brendshëm dhe ndërkombëtar	30
F. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	31
Neni 20 – Mbështetja dhe ndjekja e zbatimit të Kartës	31

Rekomandimi CM/Rec(2021)5 mbi Kartën Evropiane të porteve të Rishikuar

Hyrje

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me qëllim ruajtjen dhe realizimin e idealeve dhe parimeve që janë trashëgimia e tyre e përbashkët dhe lehtësimi i progresit të tyre ekonomik dhe social;

Duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Seria e Traktateve Evropiane (ETS) Nr. 5, Konventa);

Duke pasur parasysh Kartën Sociale Evropiane (ETS Nr. 35, ETS Nr. 163 i rishikuar), e cila parashikon të drejtën e shëndetit, arsimimit, kulturës dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit, në ushtrimin e të cilave sporti është pjesë integrale;

Duke pasur parasysh Rezolutën e saj Res(76)41 mbi parimet për një politikë të sportit për të gjithë, siç është përcaktuar nga Konferenca e Ministrave Evropianë përgjegjës për Sportin në mbledhjen e saj të parë në vitin 1975 me titull “Karta Evropiane e Sportit për të Gjithë”, e cila u përditësua në vitet 1992 dhe 2001 si Karta Evropiane e Sporteve (Karta), e miratuar nga Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Rec(92)13 (i rishikuar), drejtuar Shteteve Anëtare mbi Kartën Evropiane të Sporteve të rishikuar, dhe që versionet e mëpasshme të Kartës japin një bazë thelbësore për politikat publike në fushën e sportit dhe i kanë dhënë mundësi shumë individëve të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në sport;

Duke pasur parasysh Kartën Ndërkombëtare të Edukimit Fizik, Aktivitetit Fizik dhe Sportit të UNESCO-s, e cila ka kontribuar në garantimin e respektimit të integritetit dhe dinjitetit të çdo qenieje njerëzore në edukimin fizik, aktivitetin fizik dhe sportin; për promovimin e aktiviteteve fizike pa diskriminim; për të luftuar përjashtimin e përjetuar nga grupet e cënueshme ose të marginalizuara; dhe njohjen e ushtrimit të sportit si një e drejtë themelore (neni 1);

Duke pasur parasysh rekomandimet e tij për Shtetet Anëtare të miratuara në fushën e sportit që nga rishikimi i fundit i Kartës Evropiane të Sportit:

- ▶ mbi parandalimin e racizmit, ksenofobisë dhe intolerancës racore në sport (Rec(2001)6);
- ▶ mbi përmirësimin e edukimit fizik dhe sportit për fëmijët dhe të rinjtë në të gjitha vendet evropiane (Rec(2003)6);
- ▶ mbi parimet e qeverisjes së mirë në sport (Rec(2005)8);
- ▶ mbi Kodin e rishikuar të Etikës Sportive (CM/Rec(2010)9);

- mbi parimin e autonomisë së sportit në Evropë (CM/Rec(2011)3);
- mbi promovimin e integritetit të sportit kundër manipulimit të rezultateve, veçanërisht trukimeve të ndeshjeve (CM/Rec(2011)10);
- mbi mbrojtjen e sportistëve fëmijëve dhe atyre të rinj nga rreziqet që lidhen me migrimin (CM/Rec(2012)10);
- mbi integrimin gjinor në sport (CM/Rec(2015)2);
- mbi promovimin e qeverisjes së mirë në sport (CM/Rec(2018)12);
- mbi artet marciale ekstreme dhe aktivitetet e ndeshjeve (CM/Rec(2021)3);

Duke pasur parasysh rezolutat e miratuara nga Konferenca e Këshillit të Evropës e 15-të Ministrave përgjegjës për Sportin në Tbilisi, më 16 tetor 2018, “Mbrojtja e të drejtave të njeriut në sport: detyrimet dhe përgjegjësitë e përbashkëta” dhe “Lufta kundër korrupsionit në sport: përshkallëzimi i veprimeve”, si dhe Deklaratën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Sportin (Deklarata e Tbilisit), e cila u miratua në të njëjtën Konferencë;

Duke pasur parasysh rezolutat e miratuara nga Konferenca e 16-të e Këshillit të Evropës të Ministrave përgjegjës për Sportin, gjatë sesionit të saj përmbyllës në internet, më 11 shkurt 2021, “Një qasje evropiane ndaj politikave sportive: rishikimi i Kartës Evropiane të Sportit” dhe “Të drejtave të njeriut në sport”;

Duke pasur parasysh se është e nevojshme të bihet dakord për një kornizë të përbashkët evropiane për zhvillimin e sportit në Evropë, bazuar në parimet e demokracisë pluraliste, shtetin e së drejtës dhe të drejtave të njeriut;

Duke theksuar se sporti mund të kontribuojë në avancimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivave të saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara;

Ndërsa:

- ▶ sporti është një aktivitet social, edukativ dhe kulturor i bazuar në zgjedhjen vullnetare, i cili inkurajon kontaktet midis vendeve evropiane dhe qytetarëve të tyre dhe luan një rol themelor në realizimin e qëllimit të Këshillit të Evropës, duke përforsuar lidhjet midis popujve dhe duke zhvilluar ndërgjegjësimin e një identiteti kulturor evropian;
- ▶ sporti mund të japë kontribute të ndryshme në mirëqenien personale dhe zhvillimin social, dhe ushtrimet fizike në veçanti ndihmojnë në promovimin e mirëqenies fizike dhe mendore;
- ▶ ka një raport reciprok të ngushtë midis kushteve të shëndosha mjedisore, aktiviteteve sportive dhe nevojës për të integruar vlerësimet mjedisore dhe parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në sport;
- ▶ sporti është gjithashtu një sektor i rëndësishëm ekonomik në Evropë në vetvete, duke kontribuar në rritjen ekonomike, zhvillimin dhe punësimin, siç është nënvizuar nga shumë studime;
- ▶ ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale dhe ndikimi i tyre në sport kanë ndodhur në Evropë me një ritëm të shpejtë që nga rishikimi i fundit i Kartës Evropiane të Sporteve në vitin 2001, duke e bërë të nevojshme një Kartë të re Evropiane të Sportit për të reflektuar këto ndryshime dhe për t'u përballur me sfidat e ardhshme;

- ▶ kombinimi i standardeve për zhvillimin e sportit dhe për etikën sportive në një standard të vetëm referencë për politikatat sportive do të ishte më efektiv;
- ▶ autoritetet publike duhet të zhvillojnë bashkëpunim reciprok me lëvizjen sportive, si bazë thelbësore e sportit, me qëllim promovimin e vlerave dhe përfitimeve të sportit, dhe në shumë shtete evropiane ndërmerren veprime qeveritare për sportin në mënyrë që të jenë plotësuese dhe të mbështesin punën e së kësaj lëvizjeje (subsidiariteti);
- ▶ struktura aktuale e sportit konkurrues në Evropë, e cila bazohet kryesisht në një konfigurim kombëtar me konkurrenca në nivele rajonale, kombëtare, kontinentale dhe globale, dhe që respekton rolin rregullator të organeve ndërkombëtare qeverisëse, ka sjellë përfitime në drejtim të zhvillimit koherent të sportin dhe solidaritetit ndërkombëtar,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

- a. të bazojnë politikatat e tyre të brendshme për sportin dhe, kur është e përshtatshme, çdo legjislacion përkatës, në Kartën Evropiane të Sportit, siç përcaktohet në Shtojcën e këtij rekomandimi;
- b. të ftojnë palët përkatëse të interesit që të marrin parasysh parimet e përcaktuara në Kartën Evropiane të Sportit në zhvillimin e politikave të tyre;
- c. të ndërmarrin hapa për të siguruar përhapjen e gjerë të Kartës Evropiane të Sportit;
- d. të sigurojë ose të lehtësojë sigurimin e informacionit dhe të dhënave që do të nevojiten për monitorimin e zbatimit të saj.

A. Dispozita hyrëse

Neni 1 – Qëllimi i Kartës

Qëllimi i kësaj Karte është të drejtojë qeveritë në hartimin dhe zbatimin e kuadrove ligjore dhe të politikave për sportin, të cilat nxjerrin në pah përfitimet e tij të shumta individuale dhe sociale (në veçanti për shëndetin, përfshirjen dhe arsimin) dhe respektojnë dhe promovojnë vlerat e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, siç parashikohen në standardet e zbatueshme të Këshillit të Evropës. Për të arritur këtë qëllim, qeveritë duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për:

1. t'i mundësuar çdo individ të marrë pjesë në sport dhe veçanërisht të sigurojnë që:

- a. të gjithë të rinjtë marrin udhëzime të edukimit fizik në institucionet arsimore dhe kanë qasje tek mundësitë për të zhvilluar aftësimin fizik, shëndetin fizik, dhe për të përfituar aftësi themelore të lëvizjes;
- b. të gjithë kanë mundësinë të marrin pjesë në sport në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm;
- c. zhvillimi i sportit është gjithëpërfshirës, vlerësohet dhe monitorohet rregullisht; dhe
- d. secili ka mundësinë të përmirësojë standardin e performancës së tij në sport përtej praktikës së tij për qëllime çlodhjeje dhe të arrijë nivele të arritjeve personale dhe/ose niveleve të përsosmërisë në një mënyrë etike, të drejtë dhe të përgjegjshme;

2. të mbrojtur dhe zhvilluar sportin e bazuar në vlera, që është një parakusht për maksimizimin e përfitimeve individuale dhe sociale të sportit, dhe veçanërisht të sigurojnë që:

- a. të mbrohen të drejtat e njeriut të atyre që janë të përfshirë ose të ekspozuar ndaj aktiviteteve të lidhura me sportin;
- b. aktivitetet sportive kontribuojnë në forcimin e qasjes dhe sjelljes në radhët e atyre që janë të përfshirë në sport;
- c. të mbrohet integriteti i organizatave sportive, konkurrimeve sportive dhe i atyre të përfshirë ose të ekspozuar ndaj aktiviteteve të lidhura me sportin;
- d. aktivitetet sportive janë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 2 – Përkufizimi i “sportit” dhe fusha e zbatimit të Kartës

1. Për qëllimet e kësaj Karte, “sport” nënkupton të gjitha format e aktivitetit fizik, të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes rastësore ose të organizuar, synojnë ruajtjen ose përmirësimin e aftësisë fizike dhe mirëqenies mendore, krijimin e marrëdhënieve shoqërore ose marrjen e rezultateve në konkurrime të të gjitha niveleve.

2. Kjo Kartë thekson tiparet e përbashkëta të një kuadri për sportin evropian dhe organizimin e tij, të kuptuara nga lëvizja sportive si modeli sportiv evropian dhe ofron udhëzime të përgjithshme për Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës për të përmirësuar legjislacionin ekzistues ose politika të tjera dhe për të zhvilluar një kornizë gjithëpërfshirëse për sportin. Ajo është specifikuar dhe plotësuar me standarde ligjërish të

detyrueshme që trajtojnë çështje kritike në fushën e sportit, të tilla si:

- a. Konventa Evropiane për Dhunën dhe Sjelljen e Pahijshme të Spektatorëve në ngjarjet sportive dhe veçanërisht në ndeshjet e futbollit (ETS Nr. 120);
- b. Konventa Anti-Doping (ETS Nr. 135);
- c. Konventa e Këshillit të Evropës për Manipulimin e Konkurrimeve Sportive (CETS nr. 215); dhe
- d. Konventa e Këshillit të Evropës për një qasje të integruar të sigurisë dhe shërbimit në ndeshjet e futbollit dhe ngjarje të tjera sportive (CETS Nr. 218).

3. Zbatimi i disa dispozitave të kësaj Karte mund t'u besohet autoriteteve sportive qeveritare ose joqeveritare ose organizatave sportive.

B. Palët e interesit

Neni 3 – Autoritetet publike

1. Roli i autoriteteve publike është kryesisht plotësues ndaj veprimit të lëvizjes sportive dhe sektorit të korporatave. Autoritetet publike janë përgjegjëse për vendosjen e kushteve kuadër dhe, sipas rastit, kërkesave ligjore që janë të nevojshme për zhvillimin e sportit. Në zhvillimin dhe administrimin e politikave sportive, autoritetet publike duhet të ndjekin qëllimet e kësaj Karte dhe të demonstrojnë se i japin prioritet të lartë respektimit të shtetit ligjor dhe parimeve të qeverisjes së mirë.
2. Duhet të sigurohet një koordinim horizontal ndërmjet politikave dhe veprimeve të të gjitha autoriteteve publike që kanë të bëjnë me sportin, për shembull autoritetet përgjegjëse për sportin, arsimin, shëndetin, shërbimet sociale, planifikimin urban dhe rajonal, kulturën, drejtësinë, monitorimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve, zbatimin e ligjit, rregullimin e basteve, mjedisin dhe zhvillimin. Duhet të sigurohet një koordinim vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe autoriteteve rajonale dhe lokale, të cilat luajnë një rol kyç në ofrimin e aktiviteteve sportive në nivelin bazë.

Neni 4 – Lëvizja sportive

1. Lëvizja sportive, e cila përbëhet nga organizata sportive joqeveritare, jofitimprurëse, është partneri kryesor i autoriteteve publike për zbatimin e politikave sportive. Organizatat e tij janë subjekt i kërkesave dhe kufizimeve të vendosura ndaj tyre nga legjisllacioni në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2. Zhvillimi i shpirtit karakteristik dhe lëvizjes vullnetare në sport duhet të inkurajohet më tej, veçanërisht përmes mbështetjes për punën e organizatave vullnetare sportive. Për këtë qëllim, autoritetet publike dhe lëvizja sportive duhet të ruajnë kushtet kuadër që favorizojnë përfshirjen aktive të vullnetarëve në sport.

3. Organizatat e lëvizjes sportive gëzojnë plotësisht lirinë e organizimit të parashikuar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Ato gëzojnë procese vendimmarrëse autonome dhe duhet të zgjedhin drejtuesit e tyre në mënyrë demokratike në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë. Si qeveritë ashtu edhe organizatat sportive duhet të njohin nevojën për respekt të ndërsjellë të vendimeve të tyre.

4. Organizatat e lëvizjes sportive që fitojnë të ardhura nga tregu i argëtimit sportiv duhet të angazhohen për solidaritet financiar midis sportit të nivelit të lartë dhe sportit bazë midis sporteve të ndryshme dhe në të gjitha rajonet e botës.

Neni 5 – Sektorët e korporatave dhe profesionale

1. Sektori i korporatave dhe ai profesional luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sportit. Dialogu dhe bashkëpunimi duhet të ndërmerret me përfaqësues të shoqërive tregtare dhe kategorive profesionale të përfshira në sport në sektorë të tillë si organizimi i aktiviteteve, ngjarjeve apo konkurrimeve; prodhimi i mallrave sportive; të ushqyerit sportiv; ndërtimi i objekteve; ofrimi i shërbimeve; dhe mediat.

2. Gjatë angazhimit me përfaqësues të këtyre sektorëve, qeveritë duhet:

- a. t'i njohin ata si nxitës të inovacionit që mund t'i shërbejnë zhvillimit të sportit;
- b. të sigurojnë që ata të respektojnë rregulloret përkatëse, për shembull për të drejtat ekonomike dhe sociale, sigurinë, kualifikimet, anti-diskriminimin, integritetin sportiv, rregullat e menaxhimit të shoqërive tregtare, dhe ato kundër korrupsionit;
- c. të nxisin miratimin e Parimeve Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave për të drejtat e njeriut dhe biznesin CM/Rec(2016)3 drejtuar Shteteve Anëtare;
- d. t'i inkurajojë ata të bashkëpunojnë me lëvizjen sportive dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e tyre në skemat e solidaritetit kur përfitojnë nga aktivitetet e zhvilluara dhe financuara nga lëvizja sportive.

C. Sporti i bazuar në vlera

Neni 6 – Të drejtat e njeriut

1. Të gjithë palët e interesit duhet të respektojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura në shkallë ndërkombëtare dhe duhet të respektojnë kuadrin e përgjithshëm të vendosur për zbatimin e tyre në biznes dhe aktivitete të tjera.

2. Qasja e kujdesit të duhur për të drejtat e njeriut në sport kërkon respektimin e të drejtave të njeriut të atyre që janë të përfshirë ose të ekspozuar ndaj aktiviteteve të lidhura me sportin dhe prandaj duhet:

- a. të sigurojë që të drejtat e njeriut të sportistëve dhe të gjithë të përfshirëve në sport të respektohen, mbrohen dhe promovohen;
- b. të luftojnë arbitraritetin dhe abuzimet e tjera në sport në mënyrë që të sigurohet respektimi i plotë i sundimit të ligjit në aktivitetet sportive, duke përfshirë qasjen në mjetet juridike, drejtësi dhe në një gjykim të drejtë në përputhje me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut;
- c. të punojnë drejt barazisë gjinore në sport dhe përmes sportit, në veçanti duke zbatuar strategjinë e integritetit gjinor në sport;

- d. të zbatojnë një politikë të tolerancës zero ndaj dhunës dhe të gjitha formave të diskriminimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë individëve dhe grupeve në një situatë të cënueshme, si fëmijët, migrantët dhe personat me aftësi të kufizuara;
- e. të punojnë drejt përfshirjes së një angazhimi të qartë për të drejtat e njeriut në politikat dhe/ose kuadrin rregullator përkatës;
- f. të mbështesin të drejtat e njeriut në kontekstin e organizimit të ngjarjeve sportive dhe të përfshijnë vlerësime dhe objektiva të të drejtave të njeriut në të gjithë ciklin jetësor të ngjarjeve të mëdha sportive, duke filluar me procesin e tenderimit dhe duke përfshirë planifikimin për një trashëgimi pozitive të qëndrueshme;
- g. të investojnë më tej në zbatimin efektiv të standardeve të të drejtave të njeriut në sport dhe përmes sportit, në veçanti duke zhvilluar partneritete qeveritare/joqeveritare dhe duke përdorur platforma me shumë palë interesi për të identifikuar dhe promovuar masat për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur shkeljeve të të drejtave të njeriut në sport.

Neni 7 – Edukimi i vlerave përmes etikës sportive

1. “Etika sportive” është një koncept pozitiv që udhëheq sjelljen njerëzore. Përkufizohet si një mënyrë e të menduarit dhe jo vetëm një mënyrë e të vepruarit. Ajo mbështet integritetin sportiv, barazinë, ndershmërinë, përsosmërinë, përkushtimin, guximin, shpirtin e skuadrës, respektimin e rregullave dhe

ligjeve, respektin për mjedisin, respektin për veten dhe të tjerët dhe një frymë komuniteti, tolerance dhe solidariteti. Ajo gjithashtu përfshin respektimin e të drejtave të njeriut dhe qëndrueshmërinë.

2. Etika sportive do të promovohet në të gjitha aktivitetet në sport, nëpërmjet politikave dhe programeve përkatëse. Duhet të ndërmerren hapat e duhur për të rritur ndërgjegjësimin për etikën sportive dhe për të ofruar mundësi të vazhdueshme të të mësuarit në këtë sferë.

3. Edukimi për mënyrën e zgjedhjes së kursit etik të veprimit brenda dhe jashtë sportit është pjesë përbërëse e kompetencave që duhet të fitohen përmes sportit. Praktikimi i sportit të bazuar në vlera mund të fuqizojë njerëzit dhe të mësojë drejtësinë, punën në grup, barazinë, disiplinën, përfshirjen, respektin dhe integritetin.

Neni 8 – Integriteti

1. “Integriteti sportiv” përfshin komponentët e integritetit personal, konkurrues dhe organizativ. Kërcënimet ndaj integritetit sportiv përfshijnë vepra penale si korrupsion, mashtrim dhe shtrëngim por edhe shkelje të rregulloreve statutores dhe disiplinore, dhe sjellje joetike. Prandaj, ndjekja e integritetit sportiv duhet të angazhojë kështu të gjithë palët e interesit dhe:

- a. të mbrojtë të gjithë njerëzit, veçanërisht të rinjtë, nga dhuna, ngacmimet dhe abuzimet, të garantojnë sigurinë fizike dhe publike të individëve dhe të nxisë respektin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të njohura në shkallë ndërkombëtare, përfshirë të drejtat sociale;

- b. të përkrahë lojën e ndershme, e cila është shumë më tepër sesa të luash brenda rregullave. Loja e ndershme përfshin konceptet e miqësisë, respektit për të gjithë dhe një ndjenjë miqësie. Ajo përfshin çështje që kanë të bëjnë me mashtrimin, përdorimin e strategjive të pandershme ndërkohë duke respektuar rregullat, manipulimin e konkurrimeve sportive dhe dopingun;
 - c. të frymëzojë një qeverisje të sportit që është në pajtim me parimet e transparencës, integritetit, demokracisë, zhvillimit dhe solidaritetit, të cilat duhet të sigurohen nga kontrollet dhe balancat, dhe mekanizmat e kontrollit.
2. Politikat e integritetit të sportit duhet të mbështeten në iniciativat me shumë palë interesi; të inkurajojnë dhe të bashkëpunojnë me sinjalizuesit dhe mediat e lira; t'i kushtojnë vëmendjeje respektimit të të drejtave të njeriut; të investojnë në edukim, parandalim dhe ndërgjegjësim; të monitorohen, duke përfshirë përdorimin e mjeteve juridike; dhe përdorimi i integritetit gjinor dhe rinor.

Neni 9 – Qëndrueshmëria

1. Parimi i qëndrueshmërisë në sport kërkon që të gjitha aktivitetet të jenë të qëndrueshme në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor, në veçanti:
- a. gjatë planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të tyre, organizatorët e aktiviteteve dhe ngjarjeve sportive duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur qëndrueshmërisë, qoftë ekonomike, sociale apo mjedisore;

- b. ndërkohë që konsumi në rritje i mallrave sportive mund të gjenerojë një ndikim pozitiv në ekonominë globale, industria duhet të marrë përgjegjësinë për zhvillimin dhe integrimin e praktikave që janë të kënaqshme në aspektin social dhe miqësore me mjedisin;
 - c. aktivitetet e brendshme dhe të jashtme duhet të kryhen me përgjegjësi, me fjalë të tjera duhet të zbatohet parimi i parandalimit (ruajtja e burimeve dhe parandalimi i rrezikut). Pronarët e infrastrukturës sportive duhet të veprojnë në mënyrë proaktive për të identifikuar efektet dhe pasojat e objekteve të tyre, për të shmangur dëmtimin e mundshëm të natyrës dhe, kur është e nevojshme, të marrin masa kundërvepruese dhe mbrojtëse ndaj rreziqeve të tilla;
 - d. organizimi i ngjarjeve të mëdha sportive duhet të sigurojë një trashëgimi të qëndrueshme për komunitetet pritëse në lidhje me ndikimin e tyre ekonomik, social dhe mjedisor, në veçanti për të balancuar koston financiare të infrastrukturës me përdorimin e saj pas ngjarjes dhe efektin në pjesëmarrjen në sport.
2. Të gjithë palët e interesit duhet të marrin përgjegjësinë për të reduktuar gjurmën e tyre të karbonit dhe të ndjekin angazhimet dhe partneritetet për veprimin klimatik në njohjen e ndikimit gjithnjë e më negativ të ndryshimeve klimatike në shoqëri dhe në sport.

D. Sporti për të gjithë

Neni 10 – E drejta për sport

1. Qasja në sport për të gjithë konsiderohet të jetë një e drejtë themelore. Të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtën e patjetërsueshme të qasjes në sport në një mjedis të sigurt, brenda dhe jashtë mjediseve të shkollës, gjë që është thelbësore për zhvillimin e tyre personal dhe instrumental në ushtrimin e të drejtave për shëndet, arsim, kulturë dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit.
2. Asnjë diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, gjinisë ose orientimit seksual, opinionit politik ose opinionit tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, lidhjes me një pakicë kombëtare, pronësisë, lindjes ose statusit tjetër, nuk do të lejohet në lidhje me qasjen ndaj objekteve sportive apo aktiviteteve sportive.
3. Për të mbrojtur dhe promovuar këtë të drejtë, është e nevojshme që:
 - a. të sigurohet që qasja në zhvillimin e kompetencave fizike, intelektuale dhe etike përmes edukimit fizik dhe sportit është e garantuar, si brenda sistemit arsimor ashtu edhe në aspekte të tjera të jetës shoqërore;
 - b. të sigurohet që të gjithë të kenë mundësi të bollshme për të përfutur nga edukimi fizik dhe për të praktikuar sportin, për të zhvilluar aftësimin fizik dhe shëndetin fizik, për të fituar aftësi themelore të lëvizjes dhe për të arritur një nivel të arritjeve në sport që korrespondon me aftësitë e tyre;

- c. të sigurohet që të rinjtë, duke përfshirë fëmijët e moshës parashkollore, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi specifike për të shijuar programe edukuese dhe sportive të përshtatshme për kërkesat e tyre;
- d. të sigurojë që të gjithë anëtarët e një komuniteti lokal të kenë mundësi për të marrë pjesë në sport dhe që, aty ku është e nevojshme, të ndërmerren masa shtesë që synojnë t'u mundësojnë individëve ose grupeve të pa favorizuara dhe personave me aftësi të kufizuara t'i përdorin me efikasitet këto mundësi;
- e. të garantojnë që klubet sportive lokale të kenë status të përshtatshëm ligjor dhe kushte kuadër për të ofruar akses të përballeshëm në sport për të gjithë.

Neni 11 – Ndërtimi i themeleve për praktikimin e sportit

1. Duhet të ndërmerren të gjithë hapat e duhur për të zhvilluar aftësimin fizik dhe shëndetin fizik tek të rinjtë, duke u mundësuar atyre të fitojnë aftësi themelore të lëvizjes dhe t'i inkurajojnë ata të praktikojnë sportin, veçanërisht duke:

- a. siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në programet dhe mjediset e sportit, në ato çlodhëse dhe të edukimit fizik dhe që të caktohen periudha kohore të përshtatshme për këto aktivitete;
- b. siguruar trajnimin e mësuesve të kualifikuar në këtë fushë në të gjitha shkollat;
- c. siguruar që ekzistojnë mundësi të duhura për vazhdimin e ushtrimit të sportit pas arsimit të detyrueshëm;

- d. inkurajuar zhvillimin e lidhjeve të përshtatshme ndërmjet shkollave ose institucioneve të tjera arsimore, klubeve sportive të shkollave dhe klubeve sportive lokale;
- e. lehtësuar dhe zhvilluar përdorimin e objekteve sportive nga shkollat, klubet sportive lokale dhe komuniteti lokal;
- f. inkurajuar një mjedis në të cilin prindërit, mësuesit, trajnerët dhe drejtuesit i motivojnë të rinjtë që të bëjnë ushtrime të rregullta fizike;
- g. ofruar edukim për etikën sportive për nxënësit që nga shkolla fillore e tutje.

Neni 12 – Zhvillimi i pjesëmarrjes

1. Praktika e sportit, qoftë për qëllime të argëtimit në kohën e lirë dhe çlodhjes, promovimit të shëndetit apo përmirësimit të performancës, duhet të promovohet në të gjithë popullsinë nëpërmjet ofrimit të objekteve dhe programeve të përshtatshme të të gjitha llojeve dhe të qasjes tek trajnerët, instruktorët dhe stafi i kualifikuar, qofshin vullnetarë apo profesionistë.
2. Inkurajimi i ofrimit të mundësive për të marrë pjesë në sport në vendet e punës do të konsiderohet si pjesë përbërëse e një politike të ekuilibruar sportive.

Neni 13 – Përmirësimi i performancës

1. Praktikimi i sportit në nivele më të larta do të mbështetet dhe inkurajohet në mënyra të përshtatshme dhe specifike. Mbështetja do të mbulojë fusha të tilla si identifikimi i

talenteve dhe këshillimi, sigurimi i mjediseve të përshtatshme, zhvillimi i kujdesit dhe mbështetjes për sportistët që përdorin mjekësinë sportive dhe shkencën sportive në përputhje me standardet etike sportive, inkurajimi i trajnimeve shkencore dhe ofrimi i trajnimeve për trajnerët dhe të tjerët me funksione drejtuese dhe duke ndihmuar klubet që të ofrojnë struktura të përshtatshme dhe tregje konkurruese.

Neni 14 – Mbështetja e sportit të nivelit të lartë dhe atij profesional

1. Do të hartohen metoda të ofrimit të mbështetjes së duhur të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për atletët që demonstrojnë cilësi të jashtëzakonshme sportive, për t'u dhënë atyre mundësi për të zhvilluar plotësisht aftësitë e tyre sportive dhe njerëzore, duke siguruar njëkohësisht respekt të plotë për personalitetin individual dhe integritetin fizik e moral të tyre. Një mbështetje e tillë duhet të përfshijë aspekte që lidhen me identifikimin e talenteve, me karrierat e dyfishta të atletëve, me edukimin e ekuilibruar gjatë kohës që janë në institute trajnimi dhe me një integrim të qetë në shoqëri nëpërmjet zhvillimit të perspektivave të karrierës gjatë dhe pas përfshirjes në sport të nivelit të lartë.

2. Organizimi dhe menaxhimi i sportit të organizuar profesionalisht, duke përfshirë industrinë e argëtimit sportiv, do të kryhet nëpërmjet organeve kompetente dhe të mirë-qeverisura, në mbështetje të dialogut të duhur social me përfaqësuesit e sportistëve dhe të rolit rregullator të organeve përkatëse qeverisëse ndërkombëtare në lidhje me sigurimin e rregullave të harmonizuara të lojës, ruajtjen e integritetit të sportit dhe koordinimin e kalendarëve të konkurremeve.

Njerëzit që angazhohen profesionalisht në sport duhet të kenë statusin e duhur social, mbrojtje etike kundër të gjitha formave të shfrytëzimit dhe gëzimit të të drejtave ekonomike dhe sociale.

3. Organizimi i konkurrenive sportive të nivelit të lartë dhe profesional duhet të jetë në përputhje me parimin e hapjes në konkurrimet sportive, duke i dhënë përparësi meritave sportive. Organizatorët e konkurrenive duhet të punojnë për të harmonizuar nevojat dhe interesat e konkurrenive të ekipeve individuale/lokale me ato të ekipeve kombëtare.

E. Mjetet

Neni 15 – Objektet dhe aktivitetet

1. Meqenëse pjesëmarrja në sport varet pjesërisht nga shtrirja, shumëllojshmëria dhe aksesueshmëria e objekteve, planifikimi i përgjithshëm i tyre duhet të jetë çështje e autoriteteve publike. Gama e objekteve që duhet të ofrohen duhet të marrë parasysh objektet publike dhe private që janë tashmë të disponueshme. Ata që janë përgjegjës duhet të marrin parasysh kërkesat kombëtare, rajonale dhe lokale dhe të marrin masat e përcaktuara për të siguruar menaxhim të mirë dhe përdorim të sigurt dhe të plotë të objekteve.
2. Duhet të ndërmerren hapat e duhur nga pronarët e objekteve sportive për t'u dhënë mundësi personave nga grupet e pafavorizuara, përfshirë personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, të kenë akses në objekte të tilla.
3. Duhet të sigurohet një kuadër i qartë dhe duhet të ndërmerren hapat e duhur për të fuqizuar organizatorët e ngjarjeve dhe pronarët e objekteve sportive për të përmbushur detyrimet e tyre të sigurisë fizike dhe publike në mënyrë efektive.

Neni 16 – Burimet njerëzore

1. Duhet të inkurajohet zhvillimi, nga organet përkatëse, i kurseve të trajnimit që çojnë në diploma dhe kualifikime që mbulojnë të gjitha aspektet e sportit, duke përfshirë

përputhjen e tij me të drejtat e njeriut, etikën, integritetin dhe qëndrueshmërinë. Kurse të tilla duhet të jenë të përshtatshme për nevojat e pjesëmarrësve të të gjitha formave të përfshira në lloje dhe nivele të ndryshme të sportit dhe të përcaktuara për ata që punojnë si vullnetarisht ashtu edhe profesionalisht (instruktorë, trajnerë, menaxherë, zyrtarë, mjekë, oficerë sigurie, arkitektë, inxhinierë, oficerë të mbrojtjes së fëmijëve, etj.).

2. Personat e përfshirë në drejtimin ose mbikëqyrjen e aktiviteteve sportive duhet të kenë kualifikimet e duhura, me theks të veçantë në mbrojtjen e vlerave etike, integritetit dhe të drejtave të njeriut, duke përfshirë mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, sigurisë dhe shëndetit të personave në ngarkim të tyre.

3. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet vullnetarizmit. Personeli vullnetar, nëse i jepet trajnimi dhe mbikëqyrja e duhur, mund të japë një kontribut të paçmuar në zhvillimin e sportit në tërësi dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e të gjithëve në praktikën dhe organizimin e aktiviteteve sportive. Rekrutimi, trajnimi dhe mbajtja e vullnetarëve duhet të inkurajohet nëpërmjet njohjes së punës vullnetare, mbështetjes për trajnimin tërësor të trajnerëve vullnetarë dhe masave të tjera.

Neni 17 – Informacion dhe hulumtim

1. Strukturat dhe mjetet e përshtatshme për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit përkatës mbi sportin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar duhet të mbahen sipas standardeve më të përditësuara dhe të zhvillohen më tej në përputhje me përparimet përkatëse teknologjike. Kjo duhet të përfshijë veçanërisht marrjen në konsideratë të dixhitalizimit

dhe zhvillimeve të tjera të rëndësishme teknologjike dhe të përdorimit dhe aplikimit të tyre në kontekstin sportiv.

2. Kërkimi shkencor në të gjitha aspektet e sportit, duke përfshirë efektet e tij pozitive dhe negative në shëndet, çështjet e etikës dhe qeverisjes, tendencat e reja dhe parimet e tjera themelore qendrore, do të promovohen dhe mbështeten më tej. Do të merren masa për shpërndarjen dhe shkëmbimin e informacionit të tillë dhe rezultateve të një kërkimi të tillë në nivelin më të përshtatshëm – në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar – përfshirë si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të politikave të informuara sportive.

Neni 18 – Financa

1. Mbështetja dhe burimet e duhura nga fondet publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, duke përfshirë, sipas rastit, kontributet e lotarisë, dispozitat e duhura buxhetore publike, përjashtimet nga taksat, huadhënien e mjediseve, etj., do të vihen në dispozicion për përmbushjen e qëllimeve të kësaj Karte.

2. Duhet të inkurajohet mbështetja financiare e përzier publike dhe private për sportin, duke përfshirë kapacitetin e vetë sektorit të sportit për të gjeneruar dhe ndarë burimet e duhura për zhvillimin e tij të mëtejshëm, si në aspektin social ashtu edhe në aspektin e tij të nivelit të lartë.

3. Masat publike të mbështetjes për organizimin e ngjarjeve sportive duhet të jepen në dritën e standardeve përkatëse mjedisore dhe përfitimeve të qëndrueshme ekonomike dhe sociale që mund të arrijnë këto ngjarje, në mënyrë që të realizohet potenciali pozitiv i ngjarjeve sportive dhe të rritet pranimi i publikut.

Neni 19 – Bashkëpunimi i brendshëm dhe ndërkombëtar

1. Strukturat e duhura për bashkërendimin e duhur të zhvillimit dhe promovimit të sportit midis palëve të ndryshme të interesit duhet të krijohen aty ku ato nuk ekzistojnë tashmë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për të arritur qëllimet e kësaj Karte, pra duke siguruar që sporti të jetë një element strukturor i mirëqenies së shoqërisë sonë.

2. Bashkëpunimi ndërkombëtar në nivel global dhe kontinental është gjithashtu i nevojshëm për përmbushjen e synimeve të kësaj Karte. Kjo mund të arrihet përmes shkëmbimit të praktikave të mira, programeve arsimore, zhvillimit të kapaciteteve, përkrahjeve, zotimeve, si dhe treguesve dhe mjeteve të tjera të monitorimit dhe vlerësimit.

F. Dispozita përfundimtare

Neni 20 – Mbështetja dhe ndjekja e zbatimit të Kartës

1. Këshilli i Evropës në tërësi dhe organizata të tjera ndërkombëtare duhet të inkurajohen të përdorin sportin si një mjet për të promovuar vlerat dhe për të integruar sportin në strategji dhe plane veprimi.
2. Për të lehtësuar promovimin dhe zbatimin e kësaj Karte, palët përkatëse të interesit duhet të ftohen të zotohen për zbatimin e Kartës në politikat, strategjitë dhe programet e tyre.
3. Në nivel evropian, është e rëndësishme të rishikohet progresi dhe të mbështetet zbatimi i Kartës, në veçanti për të garantuar ndikimin pozitiv të sportit në shëndet, përfshirje dhe arsim, për të maksimizuar potencialin e tij për të promovuar një shoqëri civile dinamike si dhe kulturën e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit, qeverisjes demokratike dhe qëndrueshmërisë, si dhe luftimit të kërcënimeve ndaj integritetit sportiv. Marrëveshja e Pjesshme e Zgjeruar e Këshillit të Evropës për Sportin duhet të përdoret për të vlerësuar dhe promovuar progresin në zbatimin e Kartës, duke përfshirë:
 - a. lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe praktikave të mira;
 - b. mbajtjen e shkëmbimeve tematike për çështje që kanë të bëjnë me Kartën;

- c. mbledhjen dhe publikimin e informacionit për të monitoruar zbatimin e Kartës;
- d. mbështetjen e promovimit dhe zbatimit të Kartës përmes aktiviteteve të rregullta shumëpalëshe dhe specifike për një vend.

Sporti është mundësi; na mëson tolerancën dhe respektin. Na lejon të shtyjmë kufijtë tanë dhe të mësojmë nga njëri-tjetri, shpesh duke fshirë dallimet dhe kufijtë. Na bën më të fortë në shumë aspekte.

Për më shumë se katër dekada, Këshilli i Evropës ka mbrojtur lojën e ndershme dhe respektin në sport, duke luftuar korrupsionin dhe duke ndihmuar që sporti të jetë i sigurt, etik dhe i aksesueshëm për të gjithë.

Karta Evropiane e Sportit është standardi i Këshillit të Evropës, i cili përcakton parimet bazë për politikën kombëtare të sportit, duke i lejuar qeveritë t'u ofrojnë të gjithëve mundësi për të praktikuar sportin në kushte të përcaktuara siç duhet. Ai frymëzon përcaktuesit e rregullave dhe ofron udhëzime për shtetet anëtare se si të përsosin legjislacionin e tyre ekzistues të sportit ose politika të tjera dhe të zhvillojnë një strukturë gjithëpërfshirëse për sportin.

Karta ka qenë dhe është ende një pikë referimi për zhvillimin e sportit në Evropë që nga miratimi i saj në 1992, dhe vendet dhe sportet kanë përfituar nga parimet dhe vlerat që ajo mishëron. Rishikimi i fundit i saj u miratua nga Komiteti i Ministrave më 13 tetor 2021.



www.coe.int/sport

PREMS 175922

SQI

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.